


Kush ndikohet nga  
**rritja e pagës minimale**  
në Kosovë?



## Kush ndikohet nga rritja e pagës minimale në Kosovë?

Prill 2022

### — Përmbajtja

Përmbledhje ekzekutive	3
Hyrje	4
Kush do të përfitojë nga rritja e pagës minimale në Kosovë?	5
Paga minimale në vendet e Bashkimit Evropian dhe ndryshimet ndër vite në pagën minimale tek vendet e rajonit	10
Përfundime dhe rekomandime	11
Aneks	12

## Përmbledhje ekzekutive

Përcaktimi i nivelit të ri të pagës minimale në Kosovë në vitin 2022, e cila nuk është ndryshuar që nga viti 2011, është ndërlidhur me një periudhë të ngritjes së ndjeshme të çmimeve të produkteve bazë. Si rrjedhojë, edhe debati rreth normës së rritjes së pagës minimale është ndikuar nga diskursi që ajo duhet të përshtatet dhe me zhvillimet aktuale, të cilat nuk dihet se sa afatgjata do të jenë.

Qeveria e Kosovës, me një projektligj të ri, po synon ta shkëpusë pagën minimale nga tri pensione sociale si dhe t'i hapë rrugë vetës që ajo të përcaktojë pagën minimale në rast se nuk arrihet konsensus në mes të qeverisë, sindikatave të punonjësve dhe përfaqësuesve të bizneseve në Këshillin Ekonomiko-Social. Qeveria ka propozuar që paga minimale të bëhet 264 euro bruto, por që nuk është pranuar nga përfaqësuesit e punëtorëve.

Të gjeturat e këtij raporti, i cili bazohet në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës, tregojnë se rritja e pagës bruto në 264 euro afekton rreth 30% të tregut të punës apo rreth 105 mijë punonjës. Nga ta, rreth 30 mijë punonjës (28%) janë të punësuar në sektorin e tregtisë me shumicë dhe pakicë; 16 mijë (15%) në industrinë përpunuese; rreth 12 mijë (11%) në gastronomi; rreth 11.8 mijë (11%) në aktivitetet financiare dhe të sigurimit; 8.5 mijë (8%) në ndërtimtari, etj. Mbi 94% e të afektuarve nga rritja e pagës minimale janë punonjës të sektorit privat. Përveç një numri të punonjësve tek sektori i sigurisë, rritja e pagës minimale nuk e prek fare sektorin publik. Konkretisht, tek sektorë sikurse ai i arsimit dhe shëndetësisë, shumica e punonjësve të afektuar nga rritja e pagës minimale janë punonjës të bizneseve private, ku vetëm shtatë punonjës të arsimit dhe dy të shëndetësisë paguhen nga sektori publik.

Me rritjen e pagës minimale në 264 euro, raporti në mes të pagës minimale dhe mediane rritet ndjeshëm, nga 43% në 66%. Marrë parasysh ndikimin që mund të ketë rritja e pagës minimale në punësim, sidomos tek të rinjtë apo tek punonjësit me më pak shkathtësi, siç tregojnë gjetjet e studimeve të ndryshme, nivele tjera më të larta të pagës minimale sikurse prej 300, 350 apo 400 euro, e prekin një numër të lartë të punonjësve në tregun e punës dhe mund të dëmtojnë qytetarët dhe ekonominë e Kosovës. Krahas rritjes së pagës minimale, është e rëndësishme që të rriten kapacitetet zbatuese dhe monitoruese lidhur me impementimin e pagës minimale, meqë sektorët më të afektuar njehëresh janë edhe sektorët me shkallën më të lartë të informalitetit në vend.

# Hyrje

Paga minimale në Kosovë prej 130 euro për personat nën moshën 35 vjeçare dhe 170 euro për ata mbi 35 vjeç ka mbetur e pa ndryshuar që nga viti 2011. Punëdhënësit në sektorin privat janë treguar tejet jo-fleksibil në rritjen e pagave. Paga mesatare në këtë sektor është rritur për vetëm 12.8% në periudhën 2012-2020 (mesatarisht 1.7% në vit), apo nga 337 euro bruto sa ishte në vitin 2012 në 380 euro në vitin 2020.<sup>1</sup>

Marrë parasysh se vlera e pagës mesatare në sektorin privat mund të ndikohet në masë të madhe nga një masë e vogël e punëtorëve me paga të larta, rritja mesatare vjetore në këtë periudhë për grupin e të punësuarve në regjionin e pagës minimale mund të jetë edhe më e vogël se 1.7% në vit apo edhe zero. Pra, përkundër një rritjeje mesatare pozitive ekonomike të Kosovës ndër vite, rritjes së nevojave të punëtorëve dhe familjeve të tyre, punëdhënësit nuk kanë treguar gatishmëri që t'i përshtasin të ardhurat e punonjësve të tyre, duke treguar kështu një sjellje të ngjashme me atë dominuese (monopsoniste) karshi punonjësve.<sup>2</sup> Përkundër kësaj dhe premtimeve të vazhdueshme nga të gjitha partitë, paga minimale nuk është ngritur. Në nivel global, në periudhën 2010-2019, pagat minimale janë rritur në terma real në mbi 75% të shteteve që e aplikojnë atë.<sup>3</sup>

Në anën tjetër, pagat në sektorin publik në Kosovë kanë pasur në vazhdimësi rritje, e cila ka reflektuar kryesisht rritjen ekonomike në vend, vitet e përvojës së punës së punonjësve, apo edhe rritje arbitrare në prag të fushatave zgjedhore. Rritja e pagave në sektorin publik, në periudhën 2012-2020 ishte në kumulativ rreth 53.3% (mesatarisht mbi 6.3% në vit), apo nga 407 euro bruto në vitin 2012 në 624 euro bruto në vitin 2020. Si rrjedhojë, Kosova është shndërruar në një ndër vendet me raportin me të lartë mes të pagës mesatare të sektorit publik dhe atij privat, ku sektori publik është bërë më atraktiv se sa ai privat për personat aktiv në tregun e punës.

Deri më tani, paga minimale në Kosovë është përcaktuar bazuar në propozimin e Këshillit Ekonomiko-Social (KES), në të cilin kanë përfaqësuar të barabartë qeveria, sindikatat dhe bizneset, dhe ku propozimi duhet t'i marrë të paktën dy të tretat e votave. Mirëpo, në projektligjin e ri të qeverisë që shkëput pagën minimale nga disa skema pensionale, qeveria po ashtu e ndryshon dhe Ligjin e punës në pjesën që e prek pagën minimale, duke e kaluar mandatin për propozimin e pagës minimale tek ministria përgjegjëse për financa në rast se nuk arrihet një konsensus në KES.<sup>4</sup> Këtij veprimi i ka paraprirë një pozicionim i sindikatave, sidomos i atyre të sektorit publik, të cilat kërkojnë që paga minimale të rritet në 300 euro.<sup>5</sup> Ndërsa sindikatat e sektorit privat, fillimisht në vitin 2021 kishin kërkuar që paga minimale të bëhet 350 euro<sup>6</sup>, mirëpo më pas kanë ndryshuar pozicion duke kërkuar pagë minimale prej 400 euro.<sup>7</sup> Edhe parti politike parlamentare kanë kërkuar që paga minimale të jetë 400 euro bruto.<sup>8</sup>

Në këtë raport, Instituti GAP analizon ndikimin e rritjes së pagës minimale në 264 Euro, si dhe të skenarëve tjerë të prezantuar nga sindikatat e sektorit publik dhe ajo e sektorit privat, në kontekst të asaj se cilat kategori i afekton më së

1 Agjencia e Statistikave të Kosovës. ASK Data: Pagat.

2 Joseph E. Stiglitz. People, power and profits: Progressive capitalism for an age of discontent.

3 International Labor Organisation. Global Wage Report 2020-21. Burimi: <https://bit.ly/3vnBHBZ>

4 Kuvendi i Kosovës. Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përcaktojnë shumën e beneficionit në lartësi të pagës minimale, procedurat e caktimit të pagës minimale dhe shkallët tatimore në të ardhurat personale vjetore. Burimi: <https://bit.ly/3OTpFZ0>

5 Telegrafi.com. Burimi: <https://bit.ly/3L8SfmE>

6 Kohavision – KTV. Burimi: <https://bit.ly/3LlwMr3>

7 Koha.net. Burimi: <https://bit.ly/3k0E1UJ>

8 Koha.net. AAK: Paga minimale duhet të jetë 400 euro bruto, 13 prill 2022. Burimi: <https://bit.ly/38nrsVs>


shumti, ndikimin tek burrat dhe gratë, punonjësit e ri dhe më shumë. Ngjashëm, raporti prezanton gjetje të studimeve mbi ndikimin që mund të ketë rritja e pagës minimale në punësim, sidomos tek të rinjtë dhe punonjësit me më pak shkathtësi në tregun e punës.

## Kush do të përfitojë nga rritja e pagës minimale në Kosovë?

Kjo pjesë e raportit analizon tregun e punës në Kosovë bazuar në të dhënat e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) për muajin dhjetor të vitit 2021. Konkretisht, këtu përfshihen indikatorë të ndryshëm lidhur me shpërndarjen e të punësuarve sipas punës së tyre primare. Shpërndarja e punonjësve sipas të hyrave të tyre dhe ndikimi i rritjes së pagës minimale do të analizohet në raport me vlerën e propozuar të qeverisë për lartësinë e pagës minimale, si dhe ato të propozuara nga sindikatat e punonjësve të sektorit publik dhe asaj të punonjësve të sektorit privat.

Propozimi i qeverisë që paga minimale të rritet në 264 euro bruto, i cili është i përfshirë dhe në Programin e Qeverisë 2021–2025<sup>9</sup>, afekton rreth 30% të tregut të punës apo rreth 105 mijë punonjës. Mbi një e pesta e të punësuarve aktualisht marrin paga mes 170 dhe 264 euro bruto.

**Figura 1. Shpërndarja e pagave bruto në Kosovë, dhjetor 2021**




Prej punëtorëve të afektuar nga rritja e pagës minimale në 264 euro, rreth 30 mijë punonjës (28%) janë të punësuar në sektorin e tregtisë më shumicë dhe pakicë; 16 mijë (15%) në industrinë përpunuese; rreth 12 mijë (11%) në gastronomi; rreth 11.8 mijë (11%) në aktivitetet financiare dhe të sigurimit; 8.5 mijë (8%) në ndërtimtari, etj. Nga të dhënat e detajuara për këtë pjesë të prezantuar në tabelën 1 dhe 2 në aneks, vërehet se mbi 94% e të afektuarve nga rritja e pagës minimale janë punonjës të sektorit privat. Për shembull, tek sektori i arsimit, nga rritja e pagës minimale afektohen 2,232 punonjës, mirëpo 932 nga ta janë të punësuar në biznes individual dhe 1,116 të tjerë janë të punësuar në bizneset që operojnë si Shoqëri më Përgjegjësi të Kufizuar (SHPK) në sektorin privat. Këtu mund të bëjnë pjesë punonjës të cilët mbajnë kurse të ndryshme të gjuhëve, lëndëve shkencore, dhe më shumë. Ndërsa, janë vetëm shtatë punonjës në sektorin e arsimit që afektohen nga rritja e pagës minimale e të cilët paguhen nga organizatat buxhetore; konkretisht sektori publik. Ngjashëm, nga 1,335 punonjës të afektuar nga rritja e pagës minimale në sektorin e shëndetësisë, vetëm dy prej tyre janë punonjës të sektorit publik, kurse të gjithë të tjerët punojnë biznese individuale, SHPK, etj.

9 Zyra e Kryeministrit të Kosovës. Burimi: <https://bit.ly/3MkOydl>

Sektorët sikurse tregtia me shumicë dhe pakicë, industria përpunuese dhe gastronomia, janë identifikuar edhe si sektorët më shkallën më të lartë të informalitetit në vend.<sup>10</sup> Meqë krahas rritjes së pagës minimale, parashihet që të ulet në zero përqind obligimi tatimor mbi të ardhurat personale deri në pagën prej 250 euro, do të ulet incentiva e bizneseve që të qëndrojnë në informalitet dhe t'i shmangen obligimeve tatimore në paga. Andaj, rritja e pagës minimale mund të ndikojë edhe në përmirësimin e situatës për punonjësit e këtyre sektorëve, që përmes formalizimit fillojnë ta ushtrojnë edhe të drejtën e mohuar mbi pagesën e Trustit pensional nga punëdhënësi, të fillojnë të krijojnë histori bankare, etj. Gjithsesi, shkalla e realizimit të kësaj varet në masë të madhe nga ajo se sa do të ketë rritje të kapaciteteve të mbikqyrjes së zbatueshmërisë së pagës minimale.


**Figura 2. Numri i punëtorëve dhe sektorët më të ndikuar nga rritja e pagës minimale në 264 euro**



Prej atyre që përfitojnë nga rritja e pagës minimale, rreth gjysma janë punonjës të moshës 15–24 vjeç (21%) dhe 25 deri 34 vjeç (28%). Tek pjesa tjetër, 19% e punonjësve të afektuar nga rritja e pagës minimale janë të moshës 35 deri 44 vjeç; 14% janë të moshës 45–54 vjeç; 8% janë të moshës 55 deri 64 vjeç; dhe 11% janë të moshës mbi 64 vjeç.


10 Akademia e Shkencave dhe e Arteve e Kosovës. Analiza e ekonomisë në hije. Burimi: <https://bit.ly/384YzNw>

**Figura 3. Mosha e punonjësve të afektuar nga rritja e pagës minimale në 264 euro**



Nga punonjësit e prekur nga rritja e pagës minimale në 264 euro, tek sektori i industrisë me shumicë dhe pakicë ndikimi është thuajse i njëjtë tek të dy gjinitë, me rreth 15.9 mijë burra (54%) të dhe rreth 13.5 mijë gra (46%) të afektuar. Ndërsa tek sektorët apo nën-sektorët tjerë, ndikimi tek burrat dhe gratë është në raport të zhdrejtë, ku burrat dalin të jenë për dy ose më shumë herë më të afektuar nga rritja e pagës minimale. Kjo është kryesisht për shkak të një shkalle të ulët të punësimit dhe pjesëmarrjes së grave në tregun e punës në Kosovë.


**Figura 4. Shpërndarja e punonjësve me të ardhura deri në 264 euro sipas gjinisë**



Në diskursin publik, janë krijuar disa pozicione lidhur me lartësinë që duhet të ketë paga e re minimale në Kosovë, që kryesisht burojnë nga sindikatat e punonjësve të sektorit publik, asaj të sektorit privat, si dhe nga partitë politike. Të gjitha propozimet ngërthejnë vlera më të larta se kjo e propozuar nga qeveria. Më poshtë, janë prezantuar disa skenarë se sa përqind të punonjësve do të afektonin disa vlera tjera të propozuara për pagën minimale dhe si qëndrojnë ato në raport me pagën mediane bruto në vend, pagën nën të cilën paguhen 50% e punonjësve në tregun e punës.


Nëse paga minimale do të rritej në 300 euro, të cilin opsion e përkrahin disa sindikata të sektorit publik<sup>11</sup>, do të afektoheshin mbi 133 mijë punonjës apo 38% e të gjithë punësuarve dhe raporti pagë minimale/pagë mediane do të ishte 75%. Ndërsa me rritjen e pagës minimale në 350 apo 400 euro, siç kërkon sindikata e punonjësve të sektorit privat, ajo do të prekte 160 mijë deri në 180 mijë të punësuar dhe lartësia e saj e arrin vlerën e pagës mediane në vend, pra raporti pagë minimale dhe pagë mediane bëhet 100%. Një situatë e tillë i krijon efekte të padëshirueshme në tregun e punës, që ndërlidhet me humbjen e vendeve të punës; situatë kjo që do të shpjegohet më poshtë në këtë raport.

**Figura 5.** Shkalla e afektimit të pagës minimale në tregun e punës dhe raporti me pagën mediane



Sipas llojit të bizneseve apo organizatave të afektuara nga rritja e pagës minimale, rreth 48% janë SHPK, 34% biznese individuale, 11% shoqëri aksionare, 4% organizata buxhetore të sektorit publik. Ndërsa në numër shumë më të vogël janë Organizatat e Shoqërisë Civile (OJQ), ortakëritë e përgjithshme, bashkësitë fetare, partitë politike, etj (shih aneksin).

**Figura 6.** Të punësuarit nën pagën 264 euro sipas llojit të institucionit, dhjetor 2021



11 Telegrafi.com. Burimi: <https://bit.ly/3L8SfmE>



## Çka konsiderohet si pagë minimale optimale? Rreziqet e mundshme

Ekzistojnë formula dhe metodologji të ndryshme në përcaktimin e pagës minimale, të cilat ngërthejnë apo marrin parasysh variabla sikurse inflacioni, rritja ekonomike, shpërndarja e të hyrave të disa grupeve të veçanta në shoqëri, përfitimet nga sigurimet shoqërore, etj. Përveç aspekteve teknike dhe peshës që një vend dëshiron t'u japë këtyre variablave në formulën e përzgjedhur për përcaktimin e pagës minimale, në ndërkohë janë analizuar dhe efektet e lartësisë së një page minimale në raport me indikatorë tjerë, sikurse me pagën mediane. Gjetjet e raportit të Organizatës Ndërkombëtare të Punës mbi "Pagat në nivelin global gjatë periudhës 2020–21" tregojnë se shkalla e pagës minimale në raport me pagën mediane bruto në shtetet në zhvillim është rreth 67% ndërsa tek shtetet e zhvilluara rreth 55%.<sup>12</sup> Komisioni Evropian avokon për një pagë minimale në lartësinë e 60% të pagës mediane.<sup>13</sup> Me rritjen e pagës minimale në 264 euro bruto, bazuar në të dhënat e pagave të ATK për muajin dhjetor 2021, del se raporti pagë minimale dhe pagë mediane në Kosovë e arrin vlerën prej 66%.

Në përgjithësi, ekspertët e ekonomisë janë të ndarë lidhur me efektet e shkallës së pagës minimale në shkallën e përgjithshme të punësimit dhe nivelin e humbjeve të vendeve të punës (ang: disemployment effect). Mirëpo, në një numër të konsiderueshëm studimesh, të gjeturat për ndikimin negativ në punësimin dhe largimin nga puna për kategoritë sikurse të rinjtë dhe punonjësit me shkathtësi të ulëta janë më konsistente. Ngjashëm, hulumtime të bëra veçanërisht për ndikimin e pagës minimale në vende në zhvillim, vërejnë efekte në punësim dhe humbjen e vendeve të punës në këto dy kategori.<sup>14</sup> Andaj, ka edhe studime të cilat theksojnë së në vendet ku papunësia tek të rinjtë është e lartë dhe një pjesë e konsiderueshme e tregut të punës përbëhet nga punonjës pa shkathtësi të duhura, paga minimale nuk duhet të kalojë 33% të pagës mediane.<sup>15</sup> Të dhënat më lartë tregojnë se një e pesta e punonjësve në Kosovë të prekur nga rritja e pagës minimale në 264 euro bruto është ajo e të rinjëve të moshës prej 15–24 vjeç, si dhe mbi 28% janë të moshës 25–34 vjeç. Një raport i Bankës Botërore (BB) të vitit 2020, i cili tenton të modelojë ex-ante efektin e rritjes së pagës minimale në Kosovë, ndonëse jo duke përdorur të dhënat parësore të pagave nga ATK, po vetëm pagat të ndara nëpër kategori, gjen se rritja e pagës minimale në 250 euro bruto mund të ndikojë në rritjen e papunësisë (0.6 pikë përqindje), veçmas tek të rinjtë (1.1 pikë përqindje) dhe punonjësit me më pak shkathtësi (0.8 pikë përqindje).<sup>16</sup>

Po ashtu, një rrezik tjetër lidhet me kapacitetet e implementimit të pagës së re minimale. Edhe tani, mbi 11 vite pas miratimit të pagës minimale në nivelet 130 dhe 170 euro bruto, ka biznese të cilat i shmangen këtij detyrimi. Këtë e konfirmojnë edhe raportet vjetore të Trustit pensional, ku vetëm në vitin 2020 ishin rreth 4.1% e punonjësve që kishin nivel të kontributit pensional nën minimumin e lejuar ligjërisht sipas pagës minimale në fuqi.<sup>17</sup> Kjo tendencë vërehet edhe nga analizimi i pagave nga të dhënat e ATK, ku punonjës nën moshën 35 vjeçare paguhen më pak se 130 euro në muaj, si dhe punonjës mbi moshën 35 vjeçare paguhen më pak se 170 euro në muaj.

12 International Labor Organisation. Global Wage Report 2020–21. Burimi: <https://bit.ly/3vnBHBZ>

13 Vox EU – CEPR. Optimal minimum wage. Burimi: <https://bit.ly/3y6Em4G>

14 Shih përmbledhjen e studimeve të Neumark dhe Wascher mbi ndikimin e pagës minimale në punësim "Minimum wages and employment: a review of evidence from the new minimum wage research". Burimi: <https://bit.ly/3va2r7p>

15 Shih Rutkowski (2003) të cituar në punimin e Bankës Botërore "Ex-ante evaluation of the impact of increases in minimum wages on labor market outcomes in Kosovo". Burimi: <https://bit.ly/3Lo744Y>


16 Banka Botërore. "Ex-ante evaluation of the impact of increases in minimum wages on labor market outcomes in Kosovo". Burimi: <https://bit.ly/3rGDEal>

17 Trusti. Raporti vjetor 2020. Burimi: <https://bit.ly/3xG6eg3>

## Paga minimale në vendet e Bashkimit Evropian dhe ndryshimet ndër vite në pagën minimale tek vendet e rajonit

Në Bashkimin Evropian, nga vendet me një raport më të lartë mes pagës minimale dhe mediane është Gjermania, e cila ka njoftuar se nga tetori i vitit 2022 do ta rrisë pagën minimale në ekuivalent të 70% të pagës mediane.<sup>18</sup> Ngjashëm, Portugalia ka raport të pagës minimale me atë mediane në nivelin 68%; Bullgaria 66%; Malta 66%; Luksemburgu 62%; Franca 52%, etj.

**Figura 7. Paga minimale në disa shtete të Bashkimit Evropian dhe Kosovë**




Burimi: Eurostat

Po ashtu, vendet e rajonit kanë një nivel më të lartë të pagës minimale se sa Kosova aktualisht, ku secila nga to ka bërë përshtatje të shpeshtë të pagës minimale me normën e inflacionit apo rritjes ekonomike në vend. Për shembull, për një periudhë dhjetë vjeçare nga viti 2011 deri në vitin 2021, Shqipëria ka rritur pagën minimale me një normë mesatare vjetore prej 5.87%; Serbia me 15.02%; Sllovenia me 3.49%; Kroacia me 4.63%; Rumania me 11.81%; Bullgaria me 11.23%; Turqia me 0.49%. Për vendet si Maqedonia e Veriut dhe Mali i Zi mungojnë të dhënat se sa ka qenë paga minimale në vitin 2011 dhe 2012, megjithatë në një periudhë tetë vjeçare këto vende kanë rritur normën mesatare vjetore të pagës minimale me 6.15% dhe 1.45%, respektivisht.

Në vitet e fundit, konkretisht periudhën 2020–2022, Shqipëria e ka rritur pagën minimale çdo vit, fillimisht nga 211 euro në vitin 2020 në 244 euro në vitin 2021, si dhe më pas në 267 euro në vitin 2022. Sllovenia është vendi i dytë rajonal që ka pasur rritjen më të madhe të pagës minimale në periudhën 2020–2021 me 11.56%.<sup>19</sup>

<sup>18</sup> Vox Eu – CEPR. Optimal minimum wage. Burimi: <https://bit.ly/3v0jKJB>

<sup>19</sup> Eurostat. Monthly minimum wages – bi-annual data. burimi: <https://bit.ly/3EYQczl>

**Figura 8. Pagat minimale në vendet e rajonit**

Burimi: Instituti GAP duke përdorur të dhënat e Eurostat

## Përfundime dhe rekomandime

Rritja e pagës minimale gjatë vitit 2022 është e domosdoshme. Rritja e ndjeshme e çmimeve nga viti 2021 është një indikacion shtesë për rëndësinë e krijuar sidomos tek punonjësit e sektorit privat në pragun e ulët të pagave, e të cilët paraqesin gjysmën e punonjësve. Gjithsesi, për të mos krijuar efekte negative në tregun e punës, sikurse shtytjen e bizneseve që të reduktojnë numrin e vendeve të punës, siç tregojnë gjetjet e studimeve të ndryshme tek vendet në zhvillim, rritja e pagës minimale duhet të jetë në një raport të pranueshëm sipas praktikave më të mira nga vendet tjera. Rritja e pagës minimale përtej 264 euro bruto, e cila po ashtu është relativisht e lartë, mund të ketë efekte të dëmshme pikërisht në jetën e punonjësve, kushtet e të cilëve po synohet të përmirësohen me rritjen e pagës minimale.

Po ashtu, mbetet e rëndësishme që krahas rritjes së pagës minimale, institucionet qeveritare t'i shpeshtojnë inspektimet dhe rrisin ndëshkimet për rastet kur bizneset tentojnë të mos e deklarojnë pagën e plotë të punonjësve në ATK. Kjo, pasi që sektorët kryesorë të cilët do të afektohen nga rritja e pagës minimale në 264 euro, sikurse tregtia me shumicë dhe pakicë, industria përpunuese, gastronomia dhe ndërtimi, janë sektorë të cilët janë evidentuar për shkallën më të lartë të informalitetit në vend.

# Aneks

**Tabela 1.** Të gjithë sektorët e ndikuar nga rritja e pagës minimale në 264 euro

Sektori	Numri i punëtorëve me paga deri në 264 €	Në përqindje
Tregtia me shumicë dhe pakicë	29,811	28%
Industria përpunuese	16,062	15%
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor	11,906	11%
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit	11,799	11%
Ndërtimtaria	8,545	8%
Administrimi publik dhe mbrojtja	5,849	6%
Aktivitetet e tjera shërbyese	4,610	4%
Transporti dhe magazinimi	3,629	3%
Shërbimet administrative	3,469	3%
Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale	2,401	2%
Arsimi	2,232	2%
Informimi dhe komunikimi	1,752	2%
Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi	1,689	2%
Industria nxjerrëse	938	1%
Mungon aktiviteti	572	1%
Furnizimi me ujë, kanalizimi, trajtimi i mbeturinave	263	0%
Person Fizik	260	0%
Aktivitetet e patundshmërisë	183	0%

Tabela 2.

Të gjithë sektorët e ndikuar nga rritja e pagës minimale në 264 euro sipas llojit të firmës/organizatës

	Bashkësi Fetare	Individual	Komp .pub. e kuf.	Kompani e huaj	Kompani sigurimi	Konsorcium	Kooperativa	Kooperativa Bujq.	Ndërmarrje pub.	Ndërmarrje shoq.	Odat	OIQ	Organizata Buxhetore	Ortakëri e kufizuar	Ortakëria e përgj.	Parti Politike	Person fizik	Projekt	SH.P.K.	Shoqëri akcionare	Zyrë ndërlidhëse	Ndërmarrje nën menaxhim të AKP-së
Administrimi publik dhe mbrojtja; Sigurimi social i detyrueshëm		19		41							12	30	4,394		4	115		19	1215			
Akomodimi dhe shërbimi ushqimor		5481		1										2	142				6280			
Aktivitetet e patundshmërisë		25		1					12			22							115	8		
Aktivitetet e shëndetit të njeriut dhe të punës sociale		1335		8								12	2		33				997	14		
Aktivitetet e tjera shërbyese	193	1824				1					4	1804	15	14	19			1	735			
Aktivitetet e trupave dhe organizatave ndërkombëtare												3									1	
Aktivitetet financiare dhe të sigurimit		75		31	78							5	6		3				294	11297		10
Arsimi	1	932		6								32	7	85					1166	3		
Bujqësia, Pylltaria dhe Peshkimi		867					4	11	3	2			19		5				775	3		
Furnizimi me ujë; Kanalizimi; Aktivitetet e menaxhimit dhe të trajtimit të mbeturinave		53																	167	43		
Industria nxjerrëse		41								9					7				875	1		5
Industria përpunuese		6644		9										1	122				9219	62		5
Informimi dhe komunikimi		259		32						2		1			16				1421	21		
Mungon aktiviteti	51	3										494	20			1						
Ndërtimtaria		2938		60					1						53				5451	42		
Person Fizik																	260					
Shërbimet administrative dhe mbështetëse		446		280											146				2556	41		
Transporti dhe magazinimi		1397							3	1					51				2100	77		
Tregtia me shumicë dhe pakicë; Riparimi i mjeteve motorike dhe motoçikletave		13003	109	11															16255	35		

Instituti GAP është think-tank i themeluar në tetor të vitit 2007 në Kosovë. Qëllimi kryesor i GAP-it është të tërheqë profesionistë për të krijuar një ambient të zhvillimit dhe hulumtimit profesional, që haset në institucione të ngjashme në shtetet perëndimore. Kjo gjithashtu u ofron mundësi kosovarëve për hulumtimin, zhvillimin dhe implementim e projekteve me qëllim të avancimit të shoqërisë kosovare. Prioritet për këtë Institut është mobilizimi i profesionistëve në adresimin e sfidave ekonomike, politike dhe sociale të vendit. Qëllimet kryesore të GAP-it janë të plotësojë zbrazëtitë mes qeverisë dhe qytetarëve, si dhe të plotësojë zbrazëtitë në mes të problemeve dhe zgjidhjeve.


[www.institutigap.org](http://www.institutigap.org)

Rr. Sejdi Kryeziu, Blloku 4, Nr.4,  
10000 Prishtine

+381 38 609 339

info@institutigap.org

Instituti GAP përkrahët nga:



**Kush ndikohet nga rritja e  
pagës minimale në Kosovë?**